

SONILA BOÇI

**MARRËDHËNIET E NDËRSJELLA TË MINORITETIT
GREK ME QEVERINË KOMUNISTE SHQIPTARE
(1944-1945)**

Vera e vitit 1944 paralajmëroi problemet me të cilat do të përballëshin marrëdhëniet shqiptaro-greke pas Luftës së Dytë Botërore. Kthesa në favor të Aleatëve të Kombeve të Bashkuara, që mori situata ndërkombëtare si rezultat i fitoreve të Ushtrisë së Kuqe në Frontin e Lindjes dhe zbarkimi aleat në Normandi u dha mundësi shteteve të Ballkanit Perëndimor të mendonin për të ardhmen e tyre. Të njëjtën gjë po bënin dhe Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe, të cilat që në maj të vitit 1944 kishin filluar përpjekjet për të arritur një marrëveshje mbi ndarjen e “zonave të përgjegjësive të përkohshme në Ballkan”. Sipas kësaj ndarje Bashkimi Sovjetik do të përqendronte vëmendjen në Rumani, ndërsa Britania e Madhe në Greqi¹.

Planet e Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik u reflektuan menjëherë në situatat e brendshme politike të shteteve ballkanike përkatëse. Britania e Madhe favorizoi forcat jo komuniste të rezistencës greke, me qëllim ta siguronte Greqinë në sferën e saj të influencës. Në maj 1944, sipas rekomandimeve të britanikëve, grupet e ndryshme politike greke u takuan në Liban dhe vendosën të krijonin një qeveri koalicioni në mërgim. Qeveria e re greke e koalicionit në mërgim përbëhej nga politikanë republikanë dhe promonarkistë, dhe drejtohej nga republikani Jorgo Papandreu. Ajo nuk paraqiti ndonjë kërkesë të veçantë në lidhje me pretendimet territoriale, por ishin dhënë sinjale se dëshironin ta bënte një gjë të tillë. Karta e Libanit caktonte si qëllim të fundit të qeverisë greke “përmbushjen e plotë të kërkesave kombëtare dhe siguri të plotë mbi kufijtë e rinj të një Greqie të lirë dhe të madhe²”. Gjatë gushtit 1944, qeveria greke në mërgim disa herë i përsëriti kërkesat e saj territoriale ndaj Shqipërisë së Jugut, madje duke u përpjekur të krijojë për

¹ Winston S. Churchill, *Lufta e Dytë Botërore: kujtime*, Vëll. 4, Tiranë: “Fan Noli”, f. 234.

² *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Koleksioni i dokumenteve britanike, dosja A-V-159, Studim i Departamentit të Kërkimeve në Ministrinë e Jashtme britanike, 30 qershor 1944.

shtetin shqiptar imazhin e një shteti ndërluftues³. Më 22 nëntor 1944, qeveria greke me anë të një memorandumit për Komisionin Këshillimor Evropian, paraqiti kërkesën zyrtare në lidhje me pretendimet e saj territoriale për ishujt e Dodekanezit, Shqipërisë së Jugut dhe një rektifikim të kufijve veriorë të Greqisë me Bullgarinë⁴. Paraqitja e kërkesave zyrtare në lidhje me pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë së Jugut, u shoqërua me një fushatë propagandistike dhe diplomatike për gjoja persekutim të minoritetit grek në Shqipëri nga FANÇ dhe më pas nga Qeveria e Përkohshme Demokratike shqiptare.

Sfidat e qeverisë shqiptare dhe dilemat e minoritetit grek në fund të vitit 1944 dhe fillim të vitit 1945

Qeveria shqiptare për shkak të marrëdhënieve të tensionuara shqiptaro-greke dhe sensibilitetit që kishte minoriteti grek në situatën që po kalonte Shqipëria tregojë shumë e vëmendshme ndaj zhvillimeve në atë zonë. Madje, situata në minoritet u bë disa herë objekt i veçantë diskutimi në forumet partiake dhe shtetërore të vendit. Kështu, në Plenumin II të KQ të PKSh-së të mbajtur në Berat nga data 23-27 nëntor 1944, ku u bë bilanci i luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesit të huaj: Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste, u diskutua edhe mbi politikën e ndjekur nga PKSH ndaj minoritetit grek. Në raportin e mbajtur në të, Enver Hoxha, e vlerësoi si sukses faktin që PKSH kishte arritur të krijonte organizatat e Partisë dhe këshillat e Frontit në zonën e banuar nga minoritarë e si rezultat të përfshinte minoritetin në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare⁵. Por, ai vuri gjithashtu në dukje se gjatë Luftës, qëndrimet e Frontit Nacionalçlirimtar dhe të PKSH nuk kishin qenë gjithmonë të qarta, madje disa herë kishin rezultuar “të gabuara dhe të rrezikshme”⁶. Enver Hoxha paralajmëronte se kjo ishte “një politikë jo e drejtë dhe gabimet që kanë rezultuar në minoritet, do të na qesin mjaft pengesa, në rast se nuk marrim masat e duhura, të shpejta dhe radikale”⁷. Kritika e Enver Hoxhës, pavarësisht se nuk artikulohej qartë, lidhej me dy vendime të marra nga PKSH në lidhje me minoritetin gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vendimi i parë ishte lejimi i emisarëve të EAM-it dhe PKG për të organizuar rezistencën e

³ Stephen G. Xydis, *Greece and the Great Powers 1944-1947 – prelude to the “Truman Doctrine”*, Thessaloniki: “Institute for Balkan Studies”, 1963, f. 42; si dhe Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f. 112.

⁴ *Po aty*, 61.

⁵ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat 23-27 nëntor 1944*, (përmbledhje dokumentesh), përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Tiranë: “Eurorilindja”, 1996, f. 29.

⁶ *Po aty*, f. 39.

⁷ *Po aty*, f. 29.

popullsisë minoritare kundër pushtuesve të huaj italianë dhe gjermanë. Kjo jo vetëm kishte shërbyer për ruajtjen dhe forcimin e ndjenjave kombëtare pro-greke të popullsisë minoritare, por nxiti dhe qëndrime të skajshme nacionaliste që penguan zgjerimin e strukturave të PKSh dhe veprimtarinë e tyre. Kështu, pas largimit të emisarëve të EAM-it, në të gjithë zonën ku jetonte minoriteti grek kishte vetëm 2-3 celula të PKSH me 5-6 anëtarë⁸. Gabimi i dytë lidhej me artikulumin dhe qëndrimin e papërcaktuar e të lëkundur që kishin mbajtur të dërguarit e PKSh në konferencat e zhvilluara gjatë Luftës në Poliçan (shtator 1943) dhe në Konispol (nëntor 1943) për të drejtën e vetëvendosjes së minoritetit grek⁹. Si pasojë e këtij qëndrimi, popullsia e minoritetit, madje dhe mbështetësit e komunistëve, prisnin zhvillimin e një plebishiti, në të cilin ata të shpreheshin se me cilin nga shtetet kërkonin të bashkoheshin.

Në raportin e Enver Hoxhës shprehej shqetësim që si Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, ashtu dhe PKSh nuk kishte baza të forta në minoritet, që një pjesë e minoritetit grek nuk ishin të bindur për të qëndruar si pjesë e shtetit shqiptar dhe për rrjedhojë ekzistonte rreziku që në të ardhmen të përballëshin me një lëvizje të tyre shpërndarëse.

Në kushtet kur presioni grek për pretendimet territorial po shfaqej fuqishëm, dhe Aleatët Perëndimorë, veçanërisht Britania e Madhe po bënin sondazhe për mundësinë e një plebishiti në Shqipërinë e Jugut¹⁰, frika e qeverisë shqiptare ishte e justifikuar. Minoriteti grek, në këtë rast, mund të bëhej rrezik real për cenimin e integritetit territorial të shtetit shqiptar. Enver Hoxha dhe PKSh e vuri theksin në krijimin në zonën e minoritetit të strukturave të fuqishme partiake, mbështetëse për PKSH, të cilat të zgjonin tek ai “koshiencën politike që t’i bëjnë të ruhen nga manevrat e jashtme”¹¹. Sipas E. Hoxhës, kjo mungesë ndërgjegjësimi politik i kishte bërë minoritarët grekë, të kërkonin “të hyjnë në ambientin e tyre”¹², pra të bashkoheshin me Greqinë.

⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 14 / Arkivi i PPSH (më tej: AP) strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 12, Raport i Petro Kitës për KQ të PKSH mbi gjendjen në minoritetin grek.

⁹ Për më tepër në lidhje me këto konferenca shiko: Sonila Boçi, “Minoriteti grek në Shqipëri midis rezistencës shqiptare dhe asaj greke (1942-1944)”, në: *Studime historike*, 3-4, Tiranë 2008, f. 147-149.

¹⁰ Në tetor 1944, pas formimit të qeverisë së përkohshme shqiptare, Aleatët Perëndimorë, duhet të kenë përmendur çështjen e zhvillimit të një plebishiti në krahinat e Shqipërisë së Jugut, por Enver Hoxha citohet ta ketë hedhur poshtë në mënyrë kategorike këtë ide duke u shprehur se në Shqipërinë e Jugut nuk ka tokë të huaj dhe se ajo është plotësisht shqiptare. Për më tepër shiko: *Foreign Relation of United States diplomatic paper* (më tej: FRUS), viti 1944, Vol. III, f. 282, Alexander Kirk, këshilltari politik pranë Shtabit të Forcave Aleate për Sekretarin e Shtetit, 23 tetor 1944.

¹¹ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH ...*, f. 39.

¹² *Po aty*.

Rreziku bëhej edhe më i madh për shkak të zhvillimeve politike në Greqi, në qeverinë e të cilës komunistët përbënin një pakicë dhe perspektiva e tyre për të ardhur në pushtet ishte e zymtë. “Në Greqi, - shprehej Enver Hoxha, - punët s’venë mirë, çështja e demokracisë është e dyshimtë. Dora e imperializmit ka hyrë brenda dhe do me gjithë forcën të ndalojë triumfin e demokracisë”¹³.

Pas këtyre konstatimeve, Enver Hoxha parashtrroi dhe disa detyra, që shërbyen deri në fund si një platformë e PKSh për minoritetin grek. Enver Hoxha kërkoi së pari, t’i shpjegohej minoritetit grek se në situatën në të cilën ishte Greqia, ku në pushtet ishin forcat “neofashiste”, nuk shtrohej çështja e bashkimit të tij me Greqinë. Së dyti, ai udhëzonte t’i tregohej minoritetit grek se “ata derdhën gjakun për liritë demokratike, se këto liri i kanë vetëm në Shqipëri dhe se në Greqi ato nuk janë të sigurta”¹⁴. Së treti, duhej punuar me minoritetin grek në Shqipëri, në mënyrë që ai t’i kthente sytë nga “kufijtë politikë” dhe jo nga ato etnikë¹⁵.

Por këto rekomandime të kreut të PKSh në Plenumin e Beratit nuk ishin dhe aq të lehta për t’u zbatuar në terren. Minoritarët grekë ishin në pritje të një plebishiti për zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare, opsion të cilin E. Hoxha e kishte hedhur poshtë vetëm disa ditë më parë në mënyrë kategorike¹⁶. Sipas Jani Karamelos, një komunist korçar, i cili në dhjetor 1944 ishte dërguar në Dropull për të punuar me minoritetin, gjendja në këtë zonë ishte e paqetë. Ai tregon se gjatë një konference ishte habitur nga pyetjet që i ishin bërë nga minoritarë, të cilët sipas tij, kishin një shkallë kulturore më të lartë se ai vetë. Pyetjet e minoritarëve e kishin vënë në vështirësi këtë të ri komunist, i cili ishte dërguar për t’u shpjeguar minoritarëve se zgjidhja më e mirë për ta ishte të qëndronin nën “regjimin popullor” që po vendosej në vend. “Pyetjet e minoritarëve, - tregon z. Karamelo, - kishin të gjithë një emërues të përbashkët: kur do të bëhej plebishiti për zgjidhjen e problemit kombëtar: kupto: shkaputjen e minoritetit dhe bashkimin me Greqinë”¹⁷. Tregimi i z. Karamelo vërtetohet edhe nga konstatimet e të dërguarit të KQ të PKSh, për të parë gjendjen në minoritet. “Në minoritet, - thuhet në një raport të dërguar nga qarku i Gjirokastrës për KQ të PKSH, - nuk mund të themi se ekziston një shovinizëm, por një ndjenjë e thjeshtë kombësie”¹⁸. Mirëpo, kufiri mes ndjenjës kombëtare dhe nacionalizmit irredentist është shpesh shumë i brishtë. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për

¹³ *Po aty.*

¹⁴ *Po aty.*

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ FRUS, viti 1944, Vol. III, f. 282, Alexander Kirk, këshilltari politik pranë Shtabit të Forcave Aleate për Sekretarin e Shtetit, 23 tetor 1944.

¹⁷ Thoma Jani Karamelo, *Marrëdhëniet shqiptaro-greke ...*, f. 52.

¹⁸ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 12, Raport i Petro Kitës për KQ të PKSH mbi gjendjen në minoritetin grek.

minoritetin grek, ndjenjat irredentiste të së cilit nxiteshin nga shteti i tyre amë, Greqia që kishte pretendimet territoriale ndaj territorit shqiptar.

Në lidhje më këtë mendoj se është e udhës të sqarohet një moment delikat. Dokumentet të shtyjnë të mendosh se një pjesë jo e vogël e minoritetit grek dëshironte dhe shpresonte bashkimin me Greqinë. Veçanërisht aktivë në idenë e bashkimit ishin fshatrat minoritare të Dropullit të Poshtëm, Pogonit të Gjirokastrës, Rrëzoma e Delvinës, dy Leshnicat e Sarandës etj.¹⁹. Por, popullsia e këtyre krahinave përbënte veçse një përqindje të vogël të Shqipërisë së Jugut. Vetë minoritarët grekë e kishin të qartë diferencën midis pretendimeve greke dhe gjendjes etnike në këtë pjesë të Shqipërisë. Minoriteti grek në Shqipëri, përveç pjesës nacionaliste të skajshme të tij, nuk mbështeste pretendimet greke për Vorio-Epirin dhe këtë e kishin konstatuar dhe anëtarët e misioneve perëndimore në bisedat e tyre me minoritarë²⁰.

Gjithsesi qeveria shqiptare, për arsye të shumta politike dhe ekonomike, nuk mund të lejonte një bazë irredentizmi në Shqipërinë e Jugut. Sfida e qeverisë shqiptare ishte e vështirë. Ajo duhej të përballonte ndërhyrjen e qeverisë dhe qarqeve nacionaliste greke në Shqipërinë e Jugut, veçanërisht në zonën e minoritetit grek; të neutralizonte dhe të mbante nën kontroll nacionalistët brenda minoritetit grek; si dhe të merrte masa për t'i harmonizuar minoritarët grekë me formën e qeverisjes në Shqipëri.

Ndërkohë minoriteti grek në Shqipëri përjetonte një qëndrim në udhëkryq. Ndërsa qeveria shqiptare përpiqej të zgjonte ndërgjegjen klasore të minoritarëve grekë, qeveria greke i bënte thirrje ndërgjegjes së tyre kombëtare. Nga duhej të anonte dhe ku duhej të mbështetej minoriteti grek: te nacionalizmi tradicional apo te përkatësia politike, një element i ri ende i pasigurt. Gjithsesi, për të zgjidhur këtë dilemë të minoritetit grek pas LIIB, ishte Shqipëria ajo që kishte interesa më të fuqishme, por dhe shanse më të shumta, pavarësisht se vështirësitë ishin të mëdha.

Sfida e parë me të cilën duhej të përballej qeveria shqiptare ishte përmirësimi i kushteve ekonomike. Raportet e shumta të ardhura nga krahinat ku banonte minoriteti grek, vinin në dukje se gjendja ekonomike nuk ishte aspak e kënaqshme, gjë që kishte shkaktuar pakënaqësi të shumta. Megjithëse krahina e Dropullit dhe zona të tjera minoritare kishin pësuar dëme më të vogla nga lufta në krahasim me krahinat fqinje të banuara nga shqiptarë, përsëri raportohej se krahina e Dropullit dhe e Pogonit, e sidomos disa fshatra, si Sotirë dhe Koshovicë kishte familje që kërcënoheshin nga uria²¹. Drejtuesit komunistë lokalë evidentojnë si shkak kryesor për këtë situatë, vendimin e marrë nga

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ Një nga drejtuesit e UNRRA-s, Floud gjatë vizitës së tij në krahinat minoritare shprehej se ishin vetë minoritarët që kishin pranuar se Vorio-Epiri nuk ekzistonte.

²¹ *Po aty*, fl. 11.

qeveria shqiptare për t'u ndaluar përkohësisht emigrantëve ekonomikë nga SHBA të dërgonin para për familjet e tyre. Duke qenë se paratë e emigrantëve ishin një nga mjetet kryesore të jetesës për pjesën më të madhe të krahinave minoritare, ky vendim pati konsekuenca të shumta në këtë zonë.

Nga ana tjetër, ndarja e ndihmave të UNRRA-s nga drejtuesit e këshillave të Frontit në qarkun e Gjirokastrës linte për të dëshiruar. Ata nuk i kishin shpërndarë ndihmat bazuar në nevojën për furnizim me ushqime të secilës nga krahinat e qarkut. Kështu, në nënprefekturën e Libohovës ishin dhënë më pak ndihma se në atë të Qendrës. Në të njëjtën mënyrë, në Lunxhëri ishin ndarë ushqime në përgjithësi dhe në sasi të konsiderueshme, kurse “në krahinën e Pogonit [një krahinë në gjendje shumë të vështirë ekonomike] u dhanë shumë pak [në krahasim me nevojat] dhe në një sasi me Dropullin që është në një gjendje më të mirë. Por, dhe në Dropullin e Poshtëm, u dha një sasi më e madhe se në Dropullin e Sipërm, ndërsa janë në po atë gjendje ekonomike”²². Kjo shpërndarje e pabarabartë e ndihmave nuk duket të ketë pasur ndonjë motiv politik. Arsyet më shumë duhen kërkuar te dallaveret që bënin anëtarët e këshillave të Frontit të ngarkuar për shpërndarjen e ndihmave. Këtu duhet të shtojmë dhe dobësitë në organizimin e punës. Raporti vëren se komiteti ekzekutiv i këshillit nacionalçlirimtar i Libohovës e kishte centralizuar shumë ndarjen e ndihmave. “Kur ndahej kripa dhe vajguri, - thuhet në raportet e dërguara nga qarku i Gjirokastrës për KQ të PKSh, - detyrohen dhe katundet më të largëta për të shkuar dhe për t'i marrë në Libohovë dhe për mungesë komunikacioni të paguajnë qiraxhinj e t'u kushtojë dyfish”²³. Kjo situatë, sipas raportit, mund të zgjidhej fare mirë nëse komiteti ekzekutiv i Libohovës do të kishte llogaritur mirë sasinë e furnizimeve që i duhej Dropullit të Sipërm dhe “kur vijnë maqinat me ushqimet për në Libohovë ta shkarkojë këtë sasi në Jergucat, apo në Vrisera, duke lënë dhe një nëpunës për shpërndarjen”²⁴.

Situatën ekonomike në minoritetin grek e ndërlikonin dhe ndërhyrjet e të dërguarve të EAM-it grek. Sipas raportit të Peço Kagjinit, një nga drejtuesit kryesorë të komitetit qarkor të PKSh për Gjirokastrën, komiteti i PKG për Epirin grek dërgonte herë pas here njerëz të bëjnë tregti për interes të PKG, “megjithëse ne i kemi thënë se është e ndaluar të kalojnë kufinë, përveç kanalit të caktuar”²⁵. Mos kontrollimi i mirë i kufirit për shkak të lëvizjeve të komunistëve grekë kishte sjellë si pasojë, sipas Peço Kagjinit, zhvillimin e kontrabandës në zonën minoritare gjatë vijës së kufirit²⁶. Kontrabanda

²² *AQSH*, Fondi 14/AP, viti 1945, dos. 96, fl. 11, Raport i Petro Kitës, të dërguarit të KQ të PKSH në qarkun e Gjirokastrës për KQ të PKSH.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Po aty*, fl. 3, Raport i Peço Kagjinit për KQ të PKSh, 26 mars 1945.

²⁶ *Po aty*.

favorizohet në një masë të madhe dhe nga gjendja e vështirë ekonomike. Marrja e masave kundër kontrabandës u bë e domosdoshme, pasi ajo ishte duke "rrezikuar t'i zbraznin tregjet tona nga mallrat e ndryshme që i çonin në Greqi"²⁷. Gjatë muajit mars 1945, rreth 40 kontrabandistë grekë dhe nga minoriteti u arrestuan.

Pasojë e drejtpërdrejtë e gjendjes së vështirë ekonomike ishte dhe konfrontimi në disa raste i ushtrisë shqiptare me popullsinë e minoritetit. Kështu, masat e qeverisë shqiptare kundër kontrabandistëve kishin shkaktuar reagimin e popullsisë. Ata ishin përballur me forcat e ushtrisë, në kohën që ato kishin shkuar për të kryer arrestimet. Popullsia në minoritetin grek e justifikonte kontrabandën, duke e konsideruar si mjetin e vetëm të jetesës, në një kohë kur nuk kishte hapësira të tjera²⁸.

Situata e vështirë ekonomike e minoritetit grek u shfrytëzua dhe nga qeveria greke. Nëse qeveria shqiptare i pohonte minoritetit se kishte arritur të drejtat dhe barazinë me popullsinë shqiptare, qeveria greke përpiqej t'i tregonte se në Greqi mund të jetonte më mirë. Sipas informacioneve që kishin drejtuesit lokalë shqiptarë, psikologjia e minoritetit grek ishte të shkonte me atë që ofronte më shumë. Qeveria greke, duke e shfrytëzuar këtë psikologji të kësaj popullsie, kishte grumbulluar pjesën më të madhe të ndihmave ushqimore që vinin nga UNRRA "në qarkun e Janinës dhe veçanërisht nëpër katundet greke që ndodhen afër kufirit tonë"²⁹.

Nuk ka dyshim që ky veprim i qeverisë greke ka motiv politik. Greqia vuante në atë kohë nga mungesa të shumta ushqimore. Koloneli Palmer, anëtar i misionit ushtarak britanik, i cili në atë kohë zhvilloi një vizitë në Greqinë e Veriut, deklaronte se atje kishte mungesa të shumta të mallrave ushqimore dhe se gjendja ekonomike në Shqipëri ishte më e mirë³⁰. Edhe kontrabanda që zhvillohej duke blerë mallra ushqimore në Shqipërinë e Jugut dhe duke i shitur në Greqinë e Veriut është tregues për mungesat në këtë zonë. Krizën e urisë me të cilën po përballlej Greqia në atë kohë e përshkruan me mjaft realizëm dhe mjeshhtëri edhe gazetari grek Stefanos Zotos, në librin e tij *Greqia, lufta për liri*³¹.

²⁷ *Po aty*, fl. 11, Raport i Petro Kitës, të dërguarit të KQ të PKSH në qarkun e Gjirokastrës për KQ të PKSH.

²⁸ *Po aty*, fl. 3, Raport i Peço Kagjinit për KQ të PKSH, 26 mars 1945.

²⁹ *Po aty*, fl. 13, Raport i Petro Kitës, të dërguarit të KQ të PKSH në qarkun e Gjirokastrës për KQ të PKSH.

³⁰ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, viti 1945, dos. 11, fl. 22.

³¹ Stephanos Zotos, *Greece: the struggle for freedom – the courageous story of greek resistance to Fascism, Nazism, Communism, 1940-1949*, New York: "Thomas Y. Crowell Company", 1967, f. 189.

Megjithatë, mendoj se edhe në këto situata të vështira, qeverisë greke i interesonte të nxiste largimin e minoritarëve nga Shqipëria. Një largim masiv i grekëve nga Shqipëria jo vetëm do të vërtetonte represionin e qeverisë shqiptare ndaj minoritetit grek, të cilin qeveria greke kishte kohë që e kishte artikuluar në kancelaritë e Aleatëve Perëndimorë, por do të ishte një fakt më shumë për të bindur Aleatët të mbështesnin aneksimin apo pushtimin grek të Shqipërisë së Jugut. Në sinkron me këtë politikë, ashtu siç kishte ndodhur dhe më parë, krahas veprimtarisë diplomatike të qeverisë greke, “lulëzoi” dhe veprimtaria e sillogjeve [në shqip – lidhje] vorio-epirote. Sillogjet vorio-epirote ishin lidhje ose organizatave të veçanta, të përbëra nga minoritarë grekë apo shqiptarë grekofilë dhe grekofonë, që kishin si qëllim kryesor shkëputjen e Shqipërisë së Jugut nga shteti shqiptar. Në dallim nga periudha të caktuara të paraluftës, veprimtaria e sillogjeve vorioepirote në këtë kohë jo vetëm tolerohej, por dhe mbështetej fuqishëm nga qeveria greke. Veprimtaria e sillogjeve vorio-epirote varionte nga fushatat propagandistike e diplomatike deri te organizimi i grupeve ilegale brenda territorit shqiptar që kryenin akte diversioniste kundër shtetit shqiptar.

Pas Luftës Dytë Botërore u krijuan një numër i madh sillogjesh vorio-epirote, por më të fuqishmet ishin ato të Korfuzit dhe Janinës. Në verë dhe në vjeshtë të vitit 1944, kur u pa qartë se Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar kishte fituar epërsi të dukshme në luftën civile të zhvilluar në Greqi, një pjesë e elementëve nacionalistë të minoritetit grek, të cilët gjatë luftës kishin mbështetur EDES-in, si: Jani Dhiamanti, Çavo Kokali, Dhimitër Maksakuli, Jorgo Zoto e të tjerë u arratisën për në Greqi dhe së bashku me elementë të skajshëm nacionalistë grekë organizuan sillogjet vorio-epirote. Me kohë në to u grumbulluan elementë nga minoriteti grek, por dhe nga krahinat me popullsi shqiptare të besimit të krishterë ortodoks. Anëtarët e këtyre sillogjeve zhvillonin një veprimtari intensive shumëformëshe për të tërhequr në Greqi popullsinë e minoritetit. Kështu në një letër që Jani Dhiamanti, kreu i sillogut vorio-epirot të Janinës i dërgonte një minoritari që e quan Pol, i kërkon pikërisht këtë gjë, kinse në Greqi kishte mundësi më të mira për t’u punësuar³². “Për momentin, - i shkruan Jani Dhiamanti, - ti duhet të kesh parasysh se interesi jonë kërkon të sjellësh këtu të gjithë personat që janë kundër [ideve të E. Hoxhës] me këtë dua të them njerëz të minoritetit dhe shqiptarë”³³. Veçanërisht aktiv në këtë kohë ishte Komiteti për Luftën e Vorio-Epirit, i drejtuar nga ish-metropoliti i Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko, si dhe Komiteti i Përpjekjes Vorio Epirote, i drejtuar nga Jani Dhiamanti.

³² Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: AMPB), Fondi: dosjet hetimore, viti 1946, dos. 1066.

³³ AMPJ, viti 1947, dos. 156/1, fl. 41.

Veprimtaria e këtyre sillogjeve brenda territorit shtetëror shqiptar, favorizohej dhe nga mundësitë e pakta të qeverisë provizore shqiptare për të kontrolluar me rigorozitet kufirin greko-shqiptar. Anëtarët e sillogjeve hynin shpesh në territorin shqiptar dhe zhvillonin propagandë irredentiste. Ato nxisnin minoritarët të organizoheshin dhe të kërkonin bashkimin me Greqinë, gjë që krijonte destabilizim në vend dhe hidhte në erë çdo përpjekje të qeverisë shqiptare për të afruar e për të vënë nën kontroll zonën e minoritetit. Në thumb të kritikës së sillogjeve u vunë ata minoritarë, të cilët mbështesnin PKSH dhe doktrinën e saj të internacionalizmit. Në një fjalim të mbajtur më 29 prill 1945 në Janinë, sekretari i Komitetit të Përpjekjes Vorio-Epirote, Jani Dhiamanti, i konsideronte anëtarët e minoritetit grek, që mbështesnin qeverinë shqiptare si “të shitur” ose që “nuk dinë se ku shkojnë”. Ai hidhte poshtë propagandën internacionaliste të PKSH dhe u kujtonte minoritarëve se ata duhet të pretendonin bashkimin me Greqinë, ashtu si Titoja pretendonte “dhe pëllëmbën e fundit të tokës jugosllave”, duke iu përmendur me këtë rast se propaganda internacionaliste komuniste nuk ishte e vërtetë. Mbështetjen më të madhe sillogjeve vorio-epirote ua jepnin individët nacionalistë në minoritetin grek, të cilët kishin pasur lidhje të vjetra me shtetin grek. Një pjesë e këtyre individëve ishin prekur nga reformat komuniste të qeverisë shqiptare, duke i dhënë një motiv më shumë përpjekjeve të tyre shkëputëse. Këta elementë ishin baza kryesore mbështetëse edhe e agjenturave greke, që arritën të krijojnë disa organizata nacionaliste, si p.sh. në Konispol, Aliko etj. Ndërsa në qytetet e tjera të Shqipërisë së Jugut, jashtë krahinave minoritare, veprimtaria e sillogjeve ishte e kufizuar.

Gjendja e vështirë ekonomike dhe ndërhyrja e qeverisë dhe qarqeve nacionaliste greke po ia vështirësonin qeverisë shqiptare vendosjen e kontrollit në zonën e banuar nga minoriteti grek. Gjatë muajve mars-prill të vitit 1945, ashtu siç kishin bërë dhe në krahina të tjera të vendit, komunistët shqiptarë u përpoqën të ngrinin administratën lokale edhe në krahinat ku banonte minoriteti grek. Zgjedhjet supozoheshin të ishin të lira dhe popullore dhe votimi bëhej i hapur me ngritje dore për miratim. Sipas udhëzimeve të KQ të PKSh njerëzit e zgjedhur duhej të ishin mbështetës të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe duhet të kishte dhe anëtarë të PKSH. Por, duket se ky proces në zonën e minoritetit nuk shkoi dhe aq mirë për qeverinë provizore shqiptare. Meqë kishte premtuar se minoriteti do të qeverisej nga “bijtë e tij” dhe meqë mungonte mbështetja e duhur në disa fshatra të minoritetit, PKSH nuk arriti të imponojë plotësisht zgjedhjen e “njerëzve të saj” në këshillat nacionalçlirimtare në këtë zonë. Këto dukuri shkaktuan shqetësim të madh te drejtuesit e lartë të PKSH dhe të qeverisë. Udhëheqësit komunistë shqiptarë kërkonin nga të zgjedhurit në këshillat nacionalçlirimtarë të bëheshin zëdhënës të reformave politike dhe ekonomike të “pushtetit popullor”. Ndërkohë, sipas raporteve të të deleguarve të organeve qendrore të partisë, të zgjedhurit rishtazi në pushtetin lokal ishin

“reaksonarë” dhe se “pushteti lokal në këto krahina ishte i dobët ... Ata [anëtarët e këshillave] më shumë shikojnë punën e tyre sesa shikojnë detyrën ... Ndër ta ekziston shpirti i tarafit, akraballëkut, burokracia, spekulimi, inaktiviteti dhe mos eksperiencia”³⁴. Veçanërisht shqetësim paraqiste për udhëheqjen komuniste shqiptare, mungesa e komunistëve në këshillat nacionalçlirimtarë në disa fshatra minoritare, por dhe fakti që ato ishin mbushur me elementë nacionalistë: “Në shumë këshilla s’ka asnjë shok [kupto: komunist] dhe ... ka elementë që nuk e njohin fare vijën tonë dhe që nuk e shikojnë me simpati pushtetin tonë. Shumë herë vetë anëtarë të këshillit qoftë të pushtetit, qoftë të Frontit, përhapin parulla se në filan datë do të vijë greku”³⁵.

Progres i ngadaltë – qeveria shqiptare dhe minoriteti grek në gjysmën e dytë të vitit 1945

Deri në verë të vitit 1945, qeveria shqiptare nuk kishte pasur shumë sukses në synimet që i kishte vënë vetes në lidhje me minoritetin grek. Ajo nuk kishte arritur të neutralizonte ndërhyrjen e sillogjeve greke. Po ashtu nuk kishte mundur as të miqësonte dhe as të vinte nën kontroll nacionalistët brenda minoritetit grek. “Populli minoritar, - thuhet në një raport të dërguar nga komiteti qarkor i PKSHE të Gjirokastrës për KQ të PKSHE, - duke mos qenë i qartë për ndryshimin që ekziston midis gjendjes së këtushme dhe asaj në Greqi, dëshiron ardhjen e Greqisë dhe le të jetë ç’ të dojë”³⁶. Duke qenë se kjo popullsi nuk ishte sqaruar për ndryshimin e regjimeve në Shqipëri dhe Greqi, në opinionin e strukturave qeverisëse shqiptare, minoriteti grek me kërkesat për bashkimin me Greqinë “luftonte pa dashur interesat e tij”³⁷. Sipas informacioneve të shumta gjatë vitit 1945, gratë në minoritetin grek ishin mbështetëset më të forta të bashkimit me Greqinë³⁸. Gratë minoritare “jo vetëm që nuk janë organizuar [në organet e FANÇ ose të PKSh], por reaksioni i ka bërë veglat e tij. Puna me to është e vështirë pasi nuk ka komuniste të zonjat që të dinë greqisht”³⁹. Gjatë kësaj kohe shumë nga drejtuesit minoritarë të Frontit apo të Pushtetit, të cilët më parë kishin mbështetur Lëvizjen Nacionalçlirimtare në minoritet, filluan të bashkëpunojnë me qarqet vorio-epirote. Ata të trembur nga zhvillimi i situatës së brendshme në Greqi dhe nga frika se mos Greqia

³⁴ *AQSh*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 13, Raport i Petro Kitës, të dërguarit të KQ të PKSHE në qarkun e Gjirokastrës për KQ të PKSHE.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*, fl. 12.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*, Fondi 14/AP(str), viti 1945, dos. 8, fl. 23, Raporti i Komitetit Qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSHE, nr. prot 444, 16 prill 1945.

³⁹ *Po aty*.

arrinte të vendoste kontrollin në Shqipërinë e Jugut, filluan të bashkëpunojnë me autoritetet vorio-epirote⁴⁰.

Në informacionet e dërguara KQ PKSh, mbizotëron përshtypja se minoriteti grek ishte indiferent për atë që ndodhte në Shqipëri, se qëndronte në pritje të zhvillimeve të situatës, se nuk donte të ishte pjesë e zhvillimeve politike në Shqipëri, ose të paktën nuk ishte i përfshirë aq sa do të donte qeveria shqiptare. PKSh dhe qeveria shqiptare bënin thirrje për të vazhduar luftën për rindërtimin e vendit, por kjo thirrje me sa duket nuk vlerësohej nga minoriteti grek. Akoma më keq, kur “minoritarët shikonin ndonjë shok që punon me drejtësi dhe për të mirën e përgjithshme dhe e detyron popullatën e katundit t’i nënshtrohet një sakrifice, ky [populli minoritar] nuk i simpatizon dhe në zgjedhje nuk i voton. Kjo vjen se populli nuk është i qartë për situatën e sotme dhe nuk e kupton se duhet të bëjë akoma sakrifica për të mirën e përgjithshme dhe për të përmirësuar të ardhmen dhe veten e tij”⁴¹.

Në këto rrethana, komiteti qarkor i PKSh i qarkut të Gjirokastrës u porositi që të bënte një punë më të madhe me minoritetin grek. Thelbi i punës, sipas kësaj porosie, ishte t’i shpjegohej minoritetit ndryshimin që ekzistonte midis qeverisë shqiptare dhe asaj greke. Por, puna propagandistike në minoritet nuk ishte aq e lehtë për drejtuesit lokalë. Një nga pengesat kryesore ishte fakti që minoritarët nuk flisnin gjuhën shqipe. Duke u gjendur para këtyre vështirësive, më 18 prill 1945 sekretari i komitetit qarkor të PKSh për qarkun e Gjirokastrës, Haki Toska, i dërgoi një telegram Koçi Xoxes, sekretar organizativ i KQ të PKSH dhe ministër i brendshëm, në të cilin kërkonte që disa minoritarë të angazhuar në ushtri, si: Spiro Xhai, Jorgo Koço, Vasil Dalani, Aleks Llapa etj. të punonin me minoritetin grek⁴². Përgjigjja e Koci Xoxes ishte: “shokët që kërkoni për minoritetin janë të gjithë me përgjegjësi në ushtri, kështu nuk mund të vijnë hë për hë⁴³”, e për rrjedhojë me minoritetin do të punohej siç ishte punuar deri atëherë.

Nga vera e vitit 1945, raportohet të ketë pasur një lloj përmirësimi të gjendjes ekonomike dhe politike në minoritet. Marrja e disa masave me karakter ekonomik, si ulja e taksave: vergjisë, xhelepit dhe të dhjetës; shpërndarja e ndihmave ushqimore; dhënia e farës falas për familjet e varfra të bujqve⁴⁴ përmirësoi disi gjendjen ekonomike të krahinave të banuara nga

⁴⁰ Për më tepër shiko: *AMPB*, Fondi: dosjet hetimore, viti 1946, dos. 1066, Deponimet e Sotir Shqevit, Nasho Pandos, Teli Harbaçit.

⁴¹ *AQSh*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 12, Raport i Petro Kitës, të dërguarit të KQ të PKSH në qarkun e Gjirokastrës për KQ të PKSH.

⁴² *Po aty*, fl. 4.

⁴³ *Po aty*, fl. 5.

⁴⁴ *Po aty*, dos. 8, fl. 26, Raport i Komitetit Qarkor i PKSH të Prefekturës Gjirokastrë për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

minoritarë. Propagandimi i Reformës Agrare dhe premtimi se grekët e Shqipërisë do të përfitonin nga reforma njësoj si shqiptarët, solli një lloj afrimi të minoritetit me qeverinë shqiptare.

Drejtuesit lokalë ishin të kënaqur se masat energjike që kishin marrë për të kontrolluar ndërhyrjen greke dhe veprimtarinë e nacionalistëve në gjirin e minoritetit kishin dhënë rezultat. Ata njoftonin organet qendrore se tashmë organet e caktuara kishin arritur të kontrollonin mjaft mirë kufirin. Gjithashtu, për të frenuar arratisjet e minoritarëve filloi të zbatoheshin internimi i familjeve të të arratisurve. Në të njëjtën kohë, shtypi zyrtar vazhdoi me tone akoma më të ashpra “luftën politike kundër reaksionit grek”⁴⁵. Duhet theksuar se në këtë kohë qeveria shqiptare ishte shumë e kujdesshme në ndërmarrjen e aksioneve të ashpra dhe masave policore kundër minoritetit grek. Është e dokumentuar se ajo kreu një sërë arrestimesh, por nuk zhvilloi ndonjë proces gjyqësor dhe të arrestuarit i liroi pas disa ditësh, duke i kthyer përsëri në vendbanimet e tyre⁴⁶.

Pas këtyre masave, udhëheqësit komunistë lokalë raportojnë se “shtresat e ulëta dhe familjet e partizanëve janë lidhur me lëvizjen tonë dhe e urrejnë gjendjen e krijuar në Greqi”⁴⁷. Informacioni i Komitetit Qarkor të PKSHE për N/Prefekturën e Përmetit, tregonte se edhe gjendja në dy fshatrat minoritare të Përmetit ishte përmirësuar dhe se ato tashmë ishin simpatizante të EAM-it. Por, tërhiqet vëmendja e organeve kompetente se fshatarësia e kësaj zone ishte e paqëndrueshme dhe “ndikohet shpejt nga reaksioni, por dhe sqarohet shpejt”⁴⁸.

Pikërisht në kohën që qeveria shqiptare kishte menduar se po e kthente situatën në minoritetin grek në favor të saj, një lëkundje ndodhi te komunistët minoritarë, që konsideroheshin avangarda e udhëheqjes komuniste shqiptare në minoritetin grek. Në një konferencë për shtyp në qershor 1945, kryetari i PKG, Niko Zahariadhisi doli në mbështetje të pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut⁴⁹. Ai deklaroi se edhe PKG njihte karakterin grek të Vorio-Epirit, por mendonte se kjo çështje duhet të zgjidhej në bazë të vullnetit të popullsisë greke që jetonte atje dhe jo me forcën e armëve siç kishte shpallur e djathta greke. Niko Zahariadhisi, megjithatë la të kuptohet se për PKG, kjo nuk ishte më kryesorja në çështjen kombëtare greke. Ai pyeste qeverinë greke se përse nuk kishte ngritur të njëjtin pretendim dhe ndaj Qipros, në të cilin jetonin gjithashtu

⁴⁵ *Po aty*, fl. 29, Raport i Komitetit Qarkor i PKSHE të n/Prefekturës së Delvinës për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

⁴⁶ *AMPB*, Fondi: dosjet hetimore, viti 1946, dos. 1066.

⁴⁷ *AQSH*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 8, fl. 28, Raport i Komitetit Qarkor i PKSHE të n/Prefekturës së Përmetit për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 26, Raport i Komitetit Qarkor i PKSHE të Prefekturës së Gjirokastër për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

⁴⁹ *National Archives and Record Administration* (më tej: *NARA*), Raporti i OSS mbi qëndrimin e së majtës greke në pretendimet territoriale greke, 21 qershor 1945.

një numër i konsiderueshëm grekësh. Deklarata e Zahariadhisit, mbështeste në një shkallë të konsiderueshme pretendimet greke për Vorio-Epirin. Deklarata shkaktoi konfuzion tek komunistët minoritarë⁵⁰, pasi ajo zhvlerësonte linjën internacionaliste, në të cilën e kishte ngritur PKSh çështjen e minoritetit. Situata ishte vërtet delikate. Deklarata e Zahariadhisit, e cila u bë në një moment shumë të vështirë për qeverinë shqiptare, e vuri atë në një pozicion shumë të pakëndshëm. Presioni i qeverisë greke për pushtimin e Shqipërisë së Jugut nga ushtria greke ishte bërë dhe më i fortë me memorandumun e Komitetit grek për Punët e Jashtme⁵¹. Ajo riktheu edhe një herë fuqishëm te minoriteti grek dilemën e identitetit klasor apo atij kombëtar. Në këto kushte, qeveria shqiptare kërkoi të evitonte me çdo kusht shpresat e komunistëve minoritarë për një bashkim të mundshëm të minoritetit grek me Greqinë, prandaj i porositi ata që “zgjidhjen e problemeve të tyre [ta bënin] nga këndvështrimi i PKSH dhe se kjo deklaratë (e Zahariadhisit) nuk përputhej me vijën shqiptare për zgjidhjen e problemit të minoriteteve”⁵², pra, që minoritarët duhet të shikonin kufijtë politikë dhe jo etnikë. Por nga ana tjetër, PKSh brenda kuadrit të internacionalizmit nuk dëshironte, gjithashtu, që të bënte propagandë negative për PKG në gjirin e minoritetit. Prandaj drejtuesit e saj i porositën komunistët minoritarë që “në popull nuk duhet folur keq për luftën greke, as kundra PKG, pasi nuk dihej se në ç’rrethana është bërë një deklaratë e tillë”⁵³. Por megjithatë te komunistët shqiptarë qetësia ishte prishur. Nuk mendoj se është rastësi formimi në këtë kohë i dy organizatave irredentiste në minoritet, ku binte në sy

⁵⁰ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 8, fl. 29, Raport i Komitetit Qarkor i PKSH të Prefekturës së Gjirokastrës për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

⁵¹ Më 20 qershor 1945 Komitetit për Punët e Jashtme të parlamentit grek i paraqiti qeverive të SHBA dhe Britanisë së Madhe një memorandum, ku theksohej se për Shqipërinë “duheshin të merreshin ... po ato masa që parashikonte për mbajtjen e qetësisë në vendet e çliruara të Evropës dhe u sanksionuan tani në Konferencën e Jaltës, midis tre Aleatëve të Mëdhenj”. Për më tepër, memorandumun grek vinte në dukje se mos marrja e këtyre masave, pra mos pushtimi i Shqipërisë nga ushtritë e Aleatëve të Mëdhenj, kishte sjellë si pasojë “persekutimet” në minoritetin grek. Në mënyrë eksplicite në të thuhej: “ndjekjet morën një pamje më të tmerrshme dhe dita-ditës, na komunikohen krime në shkallë më të gjerë se sa ato të mëparshmet. Viktimat e popullsisë greke numërohen me qindra-mijëra”. Sipas Komitetit grek për Punët e Jashtme e vetmja mënyrë për të parandaluar këtë gjendje, ishte pushtimi aleat i “Vorrio-Epirit” “duke përdorur për këtë qëllim forcat greke”. Ky okupim, sipas memorandumit, duhet të vazhdonte “derisa të caktoheshin kufijtë e jugut të Shqipërisë”, në Konferencën e ardhshme të Paqes. Për më tepër në lidhje me këtë shiko: *AMPJ*, viti 1945, dos. 59/8, fl. 144.

⁵² AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 8, fl. 26, Raport i Komitetit Qarkor i PKSH të Prefekturës Gjirokastrës për gjendjen politike, 2 korrik 1945.

⁵³ *Po aty*.

dhe pjesëmarrja e komunistëve dhe drejtuesve të rëndësishëm të pushtetit në këtë zonë.

Në këtë situatë, qeveria shqiptare dërgoi në zonën e minoritetit, ministrin e Drejtësisë, Manol Konomi. Vizita e tij zgjati nga 21-22 korriku i vitit 1945 dhe u përgatit me shumë kujdes. Ministri Manol Konomi asistoi në Delvinë në varrimin e eshtrave të disa dëshmorëve të LANÇ-it, mes tyre dhe minoritarë. Gjithashtu asistoi dhe në Konferencën e Rinisë Minoritare, si dhe bëri vizita në disa fshatra minoritare të Dropullit, çka dëshmon se minoriteti ishte kryefjala e vizitës së tij. Nga njëra anë qeveria komuniste kishte nevojë t'i tregonte minoritetit se ata kishin shanse të barabarta me shqiptarët dhe, ku kishte më mirë sesa një ministër minoritar për ta bërë këtë. Nga ana tjetër, qeveria kishte nevojë të dinte gjendjen në mënyrë reale, larg propagandës dhe raporteve që zbkuronin gjendjen. Më qartë, këtë qëllim të dytë të vizitës së Manol Konomit, na e shpjegon një telegram sekret që Koçi Xoxe i dërgonte sekretarit të komitetit qarkor të PKSH të Gjirokastrës, Haki Toskës. Në këtë telegram ai i shkruante: “duhet të kesh kujdes në pyetjet që do të bëjë ministri në lidhje me gjendjen e asaj ane dhe të minoritetit dhe në lidhje me gabimet e bëra prej nesh, të thuhet e vërteta dhe të bisedohet haptazi me ministrin pa i fshehur asgjë. Kjo, sigurisht, në bisedën që do të bëjë me ty ministri personalisht, me një fjalë, bisedë mes shokësh⁵⁴”. Fatkeqësisht nëse është zhvilluar kjo bisedë dhe se çfarë është diskutua ende për ne mbetet e panjohur.

Nga shtatori i vitit 1945, qeveria shqiptare filloi përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme të Asamblesë Kushtetuese. Impenjimi i saj ishte maksimal për të fituar në mënyrë bindëse në këto zgjedhje. Përgatitjet filluan që me riorganizimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili u shndërrua në Frontin Demokratik të Shqipërisë. Fronti i ri dhe Këshilli i ri Antifashist Nacionalçlirimtar përgatiti gjithë kuadrin ligjor që duhej për zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945. Në fund të shtatorit u miratua paketa e plotë ligjore për këto zgjedhje⁵⁵.

Fushata e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese e vuri minoritetin grek para një presioni të dyfishtë. Caktimi i datës së zgjedhjeve shkaktoi reagimin e menjëhershëm të qeverisë greke. Ajo u përpoq të nxiste minoritetin grek për të mos marrë pjesë në zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese. Abstenimi i minoritetit grek ishte një mënyrë tjetër për të arritur tek aneksimi i Shqipërisë së Jugut. Për të pasur sukses në qëllimin e tyre me konsensusin e qeverisë greke u vunë në lëvizje dhe qarqet vorio epirote të krijuara në territorin grek. Këto qarqe krijuan një rrjet të gjerë agjenturor që vepronte në gjithë zonën ndërkufitare, pra si

⁵⁴ *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 7, Telegram i Koçi Xoxes për Haki Toskën, 16 korrik 1945.

⁵⁵ Për më tepër në lidhje me këto zgjedhje shiko: Sonila Boçi, “Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945” në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë 2008, f. 85-94.

brenda kufirit shqiptar, ashtu dhe jashtë tij. Si pjesë e rrjetit agjenturor u përdorën minoritarët e arratisur në Greqi gjatë vitit 1944, si dhe oficerë dhe agjentë të shërbimit të fshehtë grek. Të gjithë këta zhvilluan në Kostanjë të Greqisë një takim për të vendosur mënyrën e punës për të pasur sukses në abstenime⁵⁶. Planet e tyre, krahas shpërndarjes së trakteve dhe propagandës gojore, përfshinin dhe akte terroriste, si: atentate dhe terrorizim të popullsisë, me qëllim që t'i shmangnin atë nga votimet. Ata filluan një fushatë të vullshme në gjirin e popullsisë greke, por edhe asaj shqiptare të krahinave të Shqipërisë së Jugut për t'i bindur për të mos marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri. Mënyra sesi agjentët grekë e shtronin çështjen ishte: “në qoftë se do të votojmë këtë radhë lidhemi pazgjidhshmërisht me Shqipërinë, kurse duke mos votuar do të kemi ç’ të themi para botës së jashtme⁵⁷”.

Kjo do të thoshte se politika greke shpresonte të përdorte mospjesëmarrjen e minoritetit grek në çështjen e brendshme të Shqipërisë si shenjë e vullnetit të popullsisë për t’u bashkuar me Greqinë. Sipas telegramit të sekretarit të komitetit qarkor të PKSH në qarkun e Gjirokastrës, Peço Kagjinit, propaganda greke kishte infiltruar gjatë kufirit⁵⁸.

Nga ana tjetër ishte qeveria shqiptare që i nxiste minoritarët jo vetëm të votonin, por të votonin patjetër për Frontin. Më 22 tetor në mbledhjen e Plenumit IV të KQ të PKSH, Enver Hoxha dha udhëzimet e fundit për zhvillimin e fushatës së zgjedhjeve. Ai porositi, ndër të tjera, se nuk ishte e rëndësishme thjesht të fitonin, por duhej fituar në mënyrë “schiacciante [në italisht: dërmuese]”⁵⁹.

Haki Toska, sekretar i komitetit qarkor të PKSh për Gjirokastrën, në diskutimin e tij në këtë plenum përmendi se udhëheqja shqiptare duhet ta shikonte me kujdes çështjen e minoritetit. Ai vuri në dukje se qeveria greke po punonte fort me të. “Reaksioni grek, - thoshte ai, - ka bërë një fushatë të madhe rreth minoritetit, sidomos me anën e mësuesve minoritarë, të cilët duke qëndruar në atë anë të kufirit, propagandojnë që të largohet i tërë minoriteti dhe të shkojë në Greqi”⁶⁰. Një nga format që kishte përdorur qeveria greke, sipas Haki Toskës, ishte dhe paraja.

Ai ishte i mendimit se me minoritetin grek duhet të punohej ndryshe nga krahinat e tjera të qarkut. “Atje niveli kulturor është më i ngritur se në çdo vend tjetër: akoma dhe një pjesë e madhe, dhe nga gratë, dinë të shkruajnë dhe të

⁵⁶ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 96, fl. 9, Telegram i Peço Kagjinit për Koci Xoxen, 30 tetor 1945.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ *Po aty*, Fondi 14/AP (organet udhëheqëse), viti 1945, dosja 2, fl. 105, Diskutimi i Haki Toskës në Plenumin IV të KQ të PKSH, 17 tetor 1945.

⁶⁰ *Po aty*.

këndojnë [lexojnë]⁶¹”. Për punën që duhej bërë me minoritetin në lidhje me fushatën elektorale, Haki Toska propozonte krijimin pranë komitetit qarkor të PKSH për Gjirokastrën të një komisioni me katër shokë minoritarë, të cilët të punonin vetëm me minoritetin grek.

Duke qenë se problemet më shqetësuese në zonën e minoritetit grek ishin gjendja e keqe ekonomike dhe largimet për në Greqi, kujdesi i drejtuesve të lartë komunistë shqiptarë ishte i përqendruar në sigurimin e ndihmave për popullsinë dhe në eliminimin e arratisjeve nga zona minoritare. Koçi Xoxe urdhëronte drejtuesit e PKSh për qarkun e Gjirokastrës se duhet të mobilizonin të gjithë organizatën dhe në bashkëpunim me Mbrojtjen Popullore dhe me ushtrinë të bëhet e mundur t’i jepet fund nevojës për ushqime⁶². Organizata duhet të punonte në popull për të mësuar të gjitha nevojat dhe t’i vinte në ndihmë për t’i zgjidhur ato. Ndërkohë që, detyra e ushtrisë dhe mbrojtjes popullore ishte të evitonte dezertimet. “Mos lini, - vazhdonte Koçi Xoxe porositë e tij, - që ky popull të lihet mënjandë dhe të braktiset, pse kështu bie në duart e reaksionit grek, por duhet të interesoheni dhe ta ndihmoni mjaft që ta shpëtoni nga vuajtjet dhe nga pozitat e reaksionit grek”⁶³.

Në të njëjtën frymë ishte dhe qarkorja që Haki Toska u dërgoi vartësve të tij në krahinat e ndryshme të qarkut të Gjirokastrës. Ai urdhëronte që, si organet partiake, ashtu dhe të Frontit, të shumëfishonin aktivitetin e tyre me rastin e zgjedhjeve. “Le të shqelmohej njëherë e mirë pasiviteti, - porosiste ai, - dhe të fillohet puna me vrull. Përdorni shpejtësi dhe aktualitet në punët. Të ndihmohet dhe të nxitet në punët e ndryshme pushteti”. Në mënyrë të veçantë ai porosiste komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të Gjirokastrës për të studiuar mundësitë që të rregullohen punimet në rrugën që shpie në Poliçan. “Këtu duhet bërë punë serioze e jo siç është bërë deri më sot. Na u kemi thënë se punimet duhet të drejtohen nga seksionet e punëve botore. Shokët [komunistët] duhet të jenë në krye të punimeve”⁶⁴. Një vëmendje të posaçme i kushtohej furnizimit të popullsisë minoritare, pasi vështirësitë në furnizim me sende ushqimore vazhdonin të ishin evidente. “Na u kemi theksuar vazhdimisht rëndësinë që ka çështja ekonomike dhe konstruktive [rindërtuese] në këtë periudhë që është e njëllotë me luftën që bëjmë na”⁶⁵. Haki Toska i tërheq vërejtjen komitetit ekzekutiv për furnizimin jo të rregullt dhe në kohën e duhur të krahinës së Pogonit, si pasojë e së cilës kishin ndodhur dhe arratisje. Për këtë

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 106, fl. 11, Radiogram i Koçi Xoxes për Haki Toskën, nr. 559, 24 tetor 1945.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*, dos. 96, fl. 10, Letër e Haki Toskës për Komitetin Ekzekutiv të këshillit popullor të Gjirokastrës, 15 nëntor 1945.

⁶⁵ *Po aty*.

u porositi që posaçërisht “tani në periodën elektorale duhet të shkojnë gjithnjë shokë në Pogon, sidomos nga të pushtetit, për të parë së afërmi hallet e popullit dhe të interesohen për zgjidhje problemesh. Të na mbani në korrent për përshtypjet dhe për nevojat e ndryshme. Kjo jo vetëm për Pogonin, por për të gjithë n/prefekturën tuaj”.

Fushata e zgjedhjeve në minoritetin grek ishte shumë intensive. Ajo, ndonëse nuk u monitorua zyrtarisht, përsëri u ndoq nga afër nga misionet e Aleatëve dhe nga shtypi perëndimor. Për shkak të reagimit të qeverisë greke ndaj përfshirjes së minoritetit në këto zgjedhje, një numër korrespondentësh të huaj vizituan gjatë fushatës minoritetin grek në Shqipëri. Kështu, më 8 nëntor 1945, një grup gazetarësh amerikanë kishin qëndruar në katundin Vanista të Dropullit të Poshtëm. Ata kishin biseduar lirisht me popullsinë minoritare. Gazetarët ishin të interesuar për marrëdhëniet e minoritetit grek me shqiptarët; për shkallën e të drejtave që kishte minoriteti; mbi provokacionet greke etj.⁶⁶. Ashtu siç ishte vendosur në mbledhjen e Byrosë Politike të 5 tetorit 1945, gjatë fushatës qeveria shqiptare evitoi të përdorte masa policore kundër popullsisë⁶⁷.

Në 15 nëntor 1945, vetëm një javë pasi kishte filluar zyrtarisht fushata elektorale, raportet që vijnë nga minoriteti tregojnë se atje kishte filluar një fushatë e fuqishme propagandistike. Minella Dalani, shefi i seksionit të agjitacion-propagandës në komitetin qarkor të PKSh për Gjirokastrën, tregon për punën e madhe që po bëhej në fushatën elektorale për minoritetin në të gjithë qarkun. Në Delvinë ishin krijuar 4 ekipe për fshatrat në të cilën jetonte minoriteti grek, si në: Leshnicë, Janicat, Shën Andre, Lupsat, Grazhdan, Malcan, Livinë, Velohovo, Dermish, Dhrovjan, fshatrat e Rezomës etj. Ekipe të ngjashme ishin krijuar për Pogonin, Dropullin dhe Rrëzën⁶⁸. Detyra e ekipeve ishte të zhvillonin mitingje për të propaganduar programin e Frontit dhe kandidatët e Frontit. Raportet tregojnë se popullsia i priste me entuziazëm votimet. Ato ishin shumë optimiste si nga numri i pjesëmarrësve në këto mitingje, edhe nga premtimi i tyre për të votuar për Frontin. Në raporte theksohej pjesëmarrja e grave në këto mitingje. Veçanërisht entuziastë paraqiten të rinjtë. Mitingjet shoqëroheshin dhe me shfaqje teatrore dhe muzikore për t’u dhënë karakter festiv.

Fushata propagandistike e komunistëve shqiptarë nuk ishte e vetmja që vepronte në minoritet në kohën e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese. Një fushatë e fuqishme zhvillohej atje dhe nga qarqet vorio-epirote, të cilat, u kërkonin minoritarëve grekë të mos merrnin pjesë në zgjedhjet shqiptare. Ata u

⁶⁶ AMPJ, viti 1946, dos. 134, fl. 139.

⁶⁷ AQSH, Fondi 14/AP, organet udhëheqëse, viti 1945, dos. 1, fl. 9.

⁶⁸ Po aty, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 141, fl. 86-87, Raport i Komitetit të Partisë (seksioni i agit-propit) për KQ të PKSH, mbi fushatën e zgjedhjeve për Asamblenë Kombëtare të 2 dhjetorit 1945, datë 15 nëntor 1945.

bënin thirrje ndjenjave kombëtare greke të minoritetit, duke u thënë se “në qoftë se do të votojmë këtë radhë, lidhemi pazgjidhshmërisht me Shqipërinë, kurse duke mos votuar do të kemi ç’ të themi para botës së jashtme”⁶⁹. Një sërë broshurash, traktesh, gazetash u hodhën në minoritetin grek nga Greqia gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Rezultati i zgjedhjeve në zonën ku jetonte minoriteti grek, nuk i kënaqi pretendimet e qeverisë greke. Por se sa impakt pati kjo propagandë dhe kjo veprimtari na e tregojnë rezultatet e votimeve për zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Janë marrë në shqyrtim rezultatet e votimeve në prefekturat e n/prefekturat e qarkut të Gjirokastrës, i cili përfshin: Gjirokastrë, Libohovë, Delvinë, Konispol, Sarandë. Në të gjitha këto gjenden fshatra të banuara nga minoriteti grek. Përqindja e pjesëmarrjes në votime në këto qarqe është si më poshtë: në dy rrethet zgjedhore të Gjirokastrës përkatësisht 89 dhe 86%; rrethi i Libohovës 80%, rrethi i dytë i Delvinës, ku kandidonin dy minoritarë: Lefter Konomi dhe Spiro Xhai morën pjesë në votime 78% e zgjedhësve; rrethi i Konispolit ku kandidonte Islam Radovicka dhe Rexho Plaku përqindja e pjesëmarrjes në votime ishte 76% dhe në rrethin e Sarandës përqindja e pjesëmarrësve në votime ishte 87%⁷⁰.

Siç mund të kuptohet nga shifrat e sipërme, pjesëmarrja në votime në zonat ku banonte minoriteti grek është më e lartë se mesatarja në shkallë vendi (10.2%), por më e ulët se në disa krahina antikomuniste në veri të Shqipërisë, në të cilat përqindja e abstenimeve kapi shifra më të larta, deri në 20%, si: në Shkodër, Krujë etj⁷¹. Në një analizë të përgjithshme mund të themi se impakti që pati propaganda greke në zonën e minoritetit grek nuk ishte shumë i kënaqshëm për qeverinë greke. Ndikimi i propagandës greke ishte më i lartë në disa fshatra minoritare të Konispolit, në rrethin e dytë të Delvinës, në Sarandë, si dhe në krahinën bilinguistike të Himarës, veçanërisht në tre fshatrat e bregut të Himarës: Himarë, Dhërmi, Palasë, ku abstenimet kapën shifrën 37.9%⁷².

Por, gjithashtu mund të themi se rezultati nuk kënaqi as qeverinë shqiptare. Në mbledhje të shumta gjatë muajit dhjetor, komiteti qarkor i PKSh për Gjirokastrën u mundua të analizojë rezultatin e zgjedhjeve. Krahas ndërhyrjes së qarqeve nacionaliste greke, sipas drejtuesve lokalë, rezultatet e dobëta ishin dhe si pasojë e performancës së vetë kandidatëve të Frontit, të caktuar për minoritetin. Kështu, në zonën zgjedhore të Delvinës pati përplasje mes dy kandidatëve të Frontit Demokratik për zonën e minoritetit: Spiro Xhait dhe Lefter Konomit, të dy minoritarë. Ata, në kundërshtim me udhëzimet që kishin marrë, bënë një luftë personale për tërheqje votash, veçanërisht Lefter

⁶⁹ *Po aty*, dos. 96, fl. 9, Telegram i Peço Kagjinit për Koçi Xoxen, 30 tetor 1945.

⁷⁰ *Po aty*, dosja 58, fl. 178.

⁷¹ *Po aty*, fl. 123-129.

⁷² *Po aty*, fl. 186.

Konomi. Ai nuk kishte propaganduar Frontin Demokratik, por ishte deklaruar si zëri i vetëm i minoritetit në Asamblenë Kushtetuese dhe u premtonte minoritarëve se do të mbronte interesat e tyre⁷³. Nga ana tjetër, Spiro Xhai, sipas një raporti të Divizionit I Sulmues, “u mundua të ushtronte presion në popull dhe te shokët e ushtrisë që të votonin për të, se ashtu e lypte interesi i Partisë”. Por Spiro Xhai në konferencat e ndryshme që zhvilloi me elektoratin fliste në emër të Frontit dhe e konsideronte frontit si të vetmen organizatë që mbronte interesat vitale të minoritetit⁷⁴. Kjo luftë që kishte filluar mes dy kandidatëve pati pasoja në votimet për Frontin. Populli, sipas raportit, ishte i zhgënjyer nga kjo fushatë e kandidatëve dhe e kishte konsideruar atë si rivalitet jo për interesat e tij, por për “kolltuk” dhe për interesat personale të kandidatëve.

Në Sarandë, gjithashtu, rezultatet e votimeve i kishin zhgënjyer udhëheqësit komunistë. Arsyet qëndronin në “parashikimin e gabuar rreth vënies së kandidaturës së Thoma Papapanos n’atë vend”⁷⁵. Kjo kandidaturë kishte shkaktuar reagimin, madje dhe nervozizmin e popullsisë së Sarandës dhe sidomos të Vurgut, pasi ai “në kohën e Zogut pat mbyllur shkollat greke dhe ... sepse ai gjatë luftës nuk kishte marrë pjesë në lëvizje”⁷⁶.

Pavarësisht se rezultati i zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese në minoritet, nuk ishte çka prisnin qeveritarët shqiptarë, ai përsëri shënoi një sukses për ta. Në fund të vitit 1945, ata mund të krenoheshin se kishin neutralizuar ndërhyrjen greke në zonën e minoritetit, madje dhe kishin bërë shumicën e minoritarëve të mbështeste Frontit.

Mund të themi se në fund të kësaj periudhe, qeveria shqiptare kishte plotësuar dy nga tri detyrat që i kishte vënë vetes në lidhje me minoritetin grek në Plenumin e Beratit. Mbetej të eliminonte nacionalistët dhe kundërshtarët e regjimit komunist brenda minoritetit. Fitorja në zgjedhje kishte hapur rrugën për vendosjen e monopolit komunist në Shqipëri, pra dhe për të plotësuar këtë detyrë të fundit.

⁷³ *Po aty*, fl. 112, Raport i komitetit të divizionit I sulmues për KQ të PKSH mbi zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, nr. 78 rez, 17 dhjetor 1945.

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ *Po aty*.

*S u m m a r y*THE RECIPROCAL RELATIONS BETWEEN THE GREEK MINORITY
AND THE ALBANIAN COMMUNIST GOVERNMENT
(1944-1945)

The end of 1944 and the beginning of 1945 was a very difficult period in the reciprocal relations between the Albanian government and the Greek minority. The Albanian government due to the strained Albanian-Greek relations and the sensitivity that the Greek minority had toward the situation in which the country was going through, it showed a great attention to the developments in that area. Furthermore, the situation in the minority it was for several time the focus of special discussions in the Albanian party and state forums.

The challenge for the Albanian government was to withstand the governmental and Greek nationalist circles intervention in South Albania, particularly in the Greek minority area, to neutralize and maintain under control the nationalists within the Greek minority, as well as to take measures to harmonize the Greek minority members with the new form of governance in Albania.

Meanwhile the Greek minority in Albania experienced a stand at the crossroad. While the Albanian government tried to awaken the class consciousness of the Greek minority members, the Greek government called on its national consciousness. On which side the Greek minority needed to be engaged and supported: the traditional nationalism or the political affiliation, this was a new element still uncertain.

However, in resolving this dilemma of the Greek minority after World War II, it was Albania that had the most powerful interests, but also numerous chances, despite the fact that the difficulties were enormous.